

Pasqyrat Financiare

ALBANIAN FIBER
TELECOMMUNICATIONS Shpk

31 Dhjetor 2024

Përmbajtja

	Faqe
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	7
DEKLARATA E HARTUESIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	18

Deklarata e hartuesit të pasqyrave financiare

Për Drejtimin dhe Ortakët e Albanian Fiber Telecommunications Shpk (referuar më poshte si “shoqëria”).

Ne kemi hartuar pasqyrat financiare të shoqërisë në bazë të dokumenteve që ju na keni ofruar. Këto pasqyra financiare përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë më 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Para hartimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, ASC CPAs shpk kreu shërbimet e kontabilitetit të cilat përfshinin regjistrimin e veprimeve kontabël dhe përgatitjen e bilancit verifikues.

Ne kemi aplikuar ekspertizën tonë në kontabilitetit dhe raportim financiar për t’ju ndihmuar në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë. Ne kemi qenë në përputhje me kërkesat etike relevante, duke përfshirë edhe parimet e integritetit, objektivitetit, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur.

Këto pasqyra financiare dhe saktësia dhe plotësia e dokumenteve dhe informacionit të vënë në dispozicionin tonë nga ana juaj, janë përgjegjësia juaj. Përgjegjësia jonë është të hartojmë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuara), Ligjin 25/2018 datë 10 Maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004.

Meqenëse shërbimi i hartimit të pasqyrave financiare nuk është një shërbim sigurie, ne nuk jemi të detyruar të verifikojmë plotësinë e dokumenteve që ju na keni ofruar për hartimin e këtyre pasqyrave financiare. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion auditimi ose një konkluzion nëse këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipëri.



Prof. Dr. Agim Binaj

Kontabel i Miratuar me deshmi nr.395, 17.07.1998

ASC CPAs sh.p.k.

ALBANIA ,1000, Tirana Str.Ibrahim Rugova , Pall.Shallvare, Apt.44

e-mail: agimbinaj01@gmail.com

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024
(në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
AKTIVET			
Mjetet monetare dhe ekuivalente	3	29,691,304	12,012,366
Llogari e kërkesa të arkëtueshme	4	4,169,185	494,767
Të tjera të drejta të arkëtueshme	5	56,413,253	57,448,814
Kosto per tu shperndare	6	-	77,879,754
Inventari	7	60,338,553	69,307,269
Totali i aktiveve afatshkurtra		150,612,295	217,142,970
Aktive afatgjat jo-materiale, neto	9	41,485,819	25,747,863
Aktive afatgjat materiale, neto	8	481,871,378	141,989,612
Totali i aktiveve afatgjata		523,357,197	167,737,475
TOTALI I AKTIVEVE		673,969,492	384,880,445
 DETYRIMET DHE KAPITALI			
Llogari e kërkesa të pagueshme	10	35,855,509	31,867,012
Paga të pagueshme & sigurime shoqërore dhe shendetësore	11	7,519,074	1,912,470
Të tjera të pagueshme	12	8,732,492	5,940,562
Totali i detyrimeve afatshkurtra		52,107,075	39,720,044
Huamarrje	13	516,008,487	325,875,038
Totali i detyrimeve afatgjata		516,008,487	325,875,038
Totali i detyrimeve		568,115,562	365,595,082
Kapitali i regjistruar	14	95,431,500	15,963,500
Fitim/Humbje te Pashperndara		3,321,860	-
Fitimi i vitit		7,100,570	3,321,863
Totali i kapitalit		105,853,930	19,285,363
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		673,969,492	384,880,445

Prof. Dr. Agim Binaj
Hartues

Albarina Lekgaj
Administrator

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024
(në Lek)

Pasqyra e Performancës

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të Ardhura			
Shitje shërbime	15	20,566,913	935,260
Të ardhurat totale nga aktiviteti		20,566,913	935,260
Prodhim i AAGJM	16	341,687,604	83,255,144
Shuma nga investimi		341,687,604	83,255,144
Kostot operative			
Kosto e mallrave	17	-142,605,380	-40,124,805
Kosto e shërbimeve		-30,075,885	-2,853,882
Shpenzime për personelin	18	-99,719,350	-20,010,465
Zhvlerësim dhe amortizim	8-9	-14,542,609	-4,759,254
Shpenzime administrative dhe të tjera	19	-55,700,840	-9,508,099
Totali i shpenzimeve operative		-342,644,064	-77,256,505
Fitimi neto nga operacionet		19,610,453	6,933,899
Te ardhura (humbje) nga shitje e aseteve	20	394,833	43,946
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	21	-11,111,098	-2,904,931
Fitimi para tatimit		8,894,188	4,072,914
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	-1,793,618	-751,053
Fitimi për vitin		7,100,570	3,321,861

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë përberëse e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024
(në Lek)

Pasqyra e Flukseve Monetare Metoda Indirekte

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Fitimi (humbja) para tatim fitimit		4,072,914	4,072,914
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale		73,452	46,527
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	8-9	14,469,156	4,712,727
Fitim nga shitja e aktiveve	20	-394,833	-43,946
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues		23,041,963	8,788,223
(Rritje) / ulje e llogarive të arkëtueshme dhe të tjera	4,5,6	75,240,898	-124,924,384
(Rritje) / ulje e inventarit	7	8,968,712	-69,307,269
Rritje / (ulje) në fëmijë dhe të tjera detyrime	10,11,12	12,387,031	36,605,700
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		119,638,604	-148,837,731
Tatim i paguar	22	-1,793,618	-751,053
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		117,844,986	-149,588,784
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit			
Blerje aktivesh afat-gjata jo-materiale		-15,811,408	-24,642,303
Blerje aktivesh afat-gjata materiale	8,9	-354,350,921	-144,491,857
Shitje aktive		394,833	393,921
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë e investimit		-369,767,496	-168,740,238
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Emetim Kapitali		79,468,000	15,863,500
Hyrje nga huatë		190,133,448	312,711,753
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë financiare		269,601,448	328,575,253
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente		17,678,938	10,246,231
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 Janar		12,012,366	1,766,135
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 Dhjetor		29,691,304	12,012,366

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024
(në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i Regjistruar	Fitim/Humbje e Pashpërndarë	Fitimi i periudhës	Totali
Gjendja më 01 Janar 2023	100,000	-	-4,584,836	-4,484,836
Pagesë Kapitali	15,863,500	-	-	15,863,500
Fitimi i periudhës	-	-	3,321,861	3,321,861
Pozicion i rregulluar	-	-	4,584,836	4,584,836
Gjendja më 31 Dhjetor 2023	15,963,500	-	3,321,860	19,285,360
Gjendja më 01 Janar 2024	15,963,500	-	3,321,860	19,285,360
Pagesë Kapitali	79,468,000	-	-	79,468,000
Fitimi i periudhës	-	-	7,100,570	7,100,570
Pozicion i rregulluar	-	3,321,860	-3,321,860	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	95,431,500	3,321,860	7,100,570	105,853,930

Shënimet e Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Albanian Fiber Telecommunications shpk ("Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që është themeluar dhe krijuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datën 05 Tetor 2021. Selia e shoqërisë është në Rruga Ibrahim Rugova, Ndertesa Nr.42, Hyrja Nr.7, Kati 2, Njësi zyre 1 dhe 7, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar pranë autoriteteve fiskale me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT) M12212027P.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim rrjetesh telekomunikacioni dhe ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë etj.

Administratore e Shoqërisë është Znj.Albarina Lekgegaj. Më 31 Dhjetor 2024 shoqëria kishte 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjës (më 31 Dhjetor 2023: 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjës.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 30 Mars 2025.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit që janë të përfshira në ligjin e ri të kontabilitetit Ligji Nr 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimësi.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë shprehur në Lekë shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë.

2.2 Standarde të reja, interpretime dhe amendime të hyrë në fuqi e të adoptuar (vazhdim)

Politikat e kontabilitetit të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar, së bashku me sa vijon (SKK) e përmirësuara dhe të adoptuar nga Kompania që nga 1 janari 2024.

2.3 Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara janë si më poshtë:

	Normat e zhvlerësimit %	Normat e zhvlerësimit %	Bazë e llogaritjes
Aktivët afatgjata materiale	2024	2023	
Mobilje dhe orëdi	10	10	Metoda lineare
Paisje elektronike	25	25	Metoda lineare
Rrjeti	8	8	Metoda lineare
Aktivët afatgjata jo materiale			
Lienca	1	1	Metoda lineare
Te tjera aktive jo-materiale	15	15	Metoda lineare

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. N.q.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivët ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Aktivët dhe detyrimet financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare konsistojnë tërësisht në llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, bazuar në shumat e faturuara.

Provizionet për borxhet e këqija njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Provizionit për borxhet e këqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arkëtueshmë ekzistuese që mund të bëhen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qënësishme dhe të cilësisë së klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (psh klientë të klasifikuar si të dyshimtë dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arkëtueshme për atë klient si provizion për borxhet e këqija.

2.5 Mjete monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arkë në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

2.6 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në LEK dhe regjistrohen duke përdorur kursin zyrtar në datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe zërat e tjerë jomonetare në pasqyrat e pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj janë përkthyer në LEK me kursin zyrtar të këmbimit në datën e pasqyrave. Diferencat e këmbimit që rezultojnë kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zërave të pasqyrave të shprehur në monedhë të huaj paraqiten si vijon (në LEK):

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94
1 CHF	104.27	112.10

2.7 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhëshme ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

2.8 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me legjislacionin shqipëtar për tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim të zërave që njihen direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatim mbi fitimin është tatim fitimi i pritshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit dhe çdo korrigjim të tatimit të pagueshëm për vitet e kaluara.

Është llogaritur Tatim fitimi në masën 1,793,618 lekë.

2.9 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, minus koston e transaksionit të ndodhur. Huamarrjet njihen më vonë me koston të amortizuar. Çdo diferencë ndërmjet parave të marra (minus kostot e transaksioneve) dhe vlerës përfundimtare do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.10 Kapitali i ortakëve

Kapitali i ortakëve përbëhet nga mjetet monetare kontribuar nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali i ortakëve kontabilizohet në shumën përkthyer në monedhën vendase të valutës së huajtë kontribuar, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

2.11 Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi i Shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme të përcaktuar për aktivet paraqet dobishmerinë e pritshme të aktiveve. Vlera kontabel e këtyre aktiveve është analizuar në Shenimin 7. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

Në kushtet e shoqërisë drejtimi ka zbatuar norma amortizimi më të vogla ndryshe nga ato të përcaktuara në ligjin nr.29/2023, për «Tatimin mbi të Ardhurat», Neni 51 «Amortizimi».

	Normat ligjore	Normat e drejtimit
Ndertesa	5%	5%
Licensa	15%	1%
Rrjeti	20%	8%
Mobilje dhe paisje zyre	20%	10%
Paisje informatike	25%	25%

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

3. Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
<u>Llogari rrjedhëse ne banka</u>		
- në monedhe vendase	3,693,193	1,055,473
- në monedhën EUR	3,954,303	8,898,607
- në monedhën USD	4,986,211	1,482,818
- në monedhën CHF	16,254,114	55,238.40
	28,887,821	11,492,136
	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
<u>Arka</u>		
- në monedhe vendase	790,992	520,229
- në monedhën EUR	12,490.45	-
- në monedhën USD	-	-
	803,483	520,229
Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalente	29,691,304	12,012,366

4. Llogari e kërkesa të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Klientë	4,169,185	494,767
Totali	4,169,185	494,767

5. Të tjera të drejta të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
TVSH e arkëtueshme	33,949,977	42,690,785
Ortaku	9,735,200	-
Paradhenie për furnizim	682,040	4,689,453
Paradhenie për punonjësit	48,000	48,000
Gjendje në Doganë	1,767,650	139,526
Shpenzime të periudhave të ardhme	9,211,343	7,937,095
Garanci për qira	983,954	943,954
Garanci të ndryshme	35,089	1,000,000
Totali	56,413,253	57,448,814

6. Inventari

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Materiale telekomunikacioni	59,526,671	69,037,946
Mallra	811,882	269,323
Totali	60,338,553	69,307,269

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

7. Aktivet afatgjata materiale

	Ndertesa	Rrjeti	Ne proces	Pajisje telekomunikacioni, mobijle & pajisje zyre	Pajisje zyre dhe informatike	Total
Kosto						
Më 1 Janar 2024	2,399,452	93,780,152	3,564,278	29,528,095	17,590,699	146,862,676
Shtesa	-	344,692,037	-	7,830,821	1,828,063	354,350,921
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	<u>2,399,452</u>	<u>438,472,189</u>	<u>3,564,278</u>	<u>37,358,916</u>	<u>19,418,763</u>	<u>501,213,597</u>
Amortizimi						
Më 1 Janar 2024	-19,995	-1,524,149	-	-1,746,363	-1,582,556	-4,873,063
Amortizimi i vitit	-	-14,469,156	-	-	-	-14,469,156
Elementë të shitur	-	-	-	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	<u>-19,995</u>	<u>-15,993,305</u>	<u>-</u>	<u>-1,746,363</u>	<u>-1,582,556</u>	<u>-19,342,219</u>
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2024	<u>2,379,456</u>	<u>92,256,002</u>	<u>3,564,278</u>	<u>27,781,732</u>	<u>16,008,143</u>	<u>141,989,612</u>
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2024	<u>2,379,456</u>	<u>422,478,883</u>	<u>3,564,278</u>	<u>35,612,553</u>	<u>17,836,206</u>	<u>481,871,378</u>

	Ndertesa	Rrjeti	Ne proces	Pajisje telekomunikacioni, mobijle & pajisje zyre	Pajisje zyre dhe informatike	Total
Kosto						
Më 1 Janar 2023	-	-	-	-	2,743,884	2,743,884
Shtesa	2,399,452	93,780,152	3,564,278	29,901,160	14,846,815	144,491,857
Pakësimet	-	-	-	-373,065	-	-373,065
Më 31 Dhjetor 2023	<u>2,399,452</u>	<u>93,780,152</u>	<u>3,564,278</u>	<u>29,528,095</u>	<u>17,590,699</u>	<u>146,862,676</u>
Amortizimi						
Më 1 Janar 2023	-	-	-	-	-183,427	-183,427
Amortizimi i vitit	-19,995	-1,524,149	-	-1,769,453	-1,399,129	-4,712,727
Elementë të shitur	-	-	-	23,091	-	23,091
Më 31 Dhjetor 2023	<u>-19,995</u>	<u>-1,524,149</u>	<u>-</u>	<u>-1,746,363</u>	<u>-1,582,556</u>	<u>-4,873,063</u>
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2023	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>2,560,457</u>	<u>2,560,457</u>
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2023	<u>2,379,456</u>	<u>92,256,002</u>	<u>3,564,278</u>	<u>27,781,732</u>	<u>16,008,143</u>	<u>141,989,612</u>

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

8. Aktive Afatgjata Jo-Materiale

	Ne proces	Jo-Materiale	Total
Kosto			
Më 1 Janar 2024	19,483,334	6,311,057	25,794,391
Shtesa	13,650,000	2,161,408	15,811,408
Pakësimet	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	33,133,334	8,472,465	41,605,798
Amortizimi			
Më 1 Januar 2024	-	-46,527	-46,527
Amortizimi i vitit	-	-73,452	-73,452
Elementë të shitur	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	-	-119,979	-119,979
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2024	19,483,334	6,264,530	25,747,863
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2024	33,133,334	8,352,485	41,485,819

	Ne proces	Jo-Materiale	Total
Kosto			
Më 1 Janar 2023	-	1,152,088	1,152,088
Shtesa	19,483,334	5,158,969	24,642,303
Pakësimet	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	19,483,334	6,311,057	25,794,391
Amortizimi			
Më 1 Januar 2023	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-46,527	-46,527
Elementë të shitur	-	-	-
Më 31 Dhjetor 2023	-	-46,527	-46,527
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2023	-	1,152,088	1,152,088
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2023	19,483,334	6,264,530	25,747,863

9. Furnitorë

Furnitorët përfshijnë detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas. Balancat e furnitorëve janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Furnitore	35,855,509	31,867,012
Totali	35,855,509	31,867,012

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

10. Paga të pagueshme

Detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore i përket muajit Dhjetor 2024.

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Paga e shperblime	5,788,089	70,147
Sigurime shoqërore e shëndetësore	1,730,985	1,842,323
Totali	7,519,074	1,912,470

Sigurimet shoqërore e shëndetësore shlyhen jo më vonë se 20 ditë pas mbylljes së muajit pasardhës.

11. Të tjera të pagueshme

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Pagesa cash nga punonjesit	655,744	655,744
Tatim fitimi	759,136	751,053
Te tjera	30,000	-
Garanci nga Klientet	1,079,811	200,417
Tatim mbi te ardhurat personale	754,595	798,606
Tatim ne burim	134,644	145,393
Detyrim qira	4,896,847	2,800,185
Te ardhura te periudhave te ardhme	421,715	589,163
Total	8,732,492	5,940,562

Detyrimet ndaj autoriteteve tatimore zakonisht shlyhen nga 10 deri në 20 ditë nga mbyllja e muajit.

12. Hua

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua Genti Daci	3,839,300	4,032,850
Hua Altin Leksani	10,878,685	10,878,685
Hua DK Invest Holding	284,474,910	172,805,500
Hua SAAL Investment Holding	192,297,780	131,257,424
Hua	491,490,674	318,974,460
Interes i akumuluar per huate Genti Daci	131,052	65,360
Interes i akumuluar per huane Altin Leksani	395,935	219,151
Interes i akumuluar per huane DK INVEST	13,660,948	3,702,425
Interes i akumuluar per huane SAAL INVEST	10,329,877	2,913,642
Interes i Pagueshem	24,517,812	6,900,579
Total	516,008,487	325,875,038

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

13. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Më 31 Dhjetor 2024, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) totali i kapitalit të regjistruar është 95,431,500 Lekë.

Më poshtë është struktura e kapitalit më 31 Dhjetor 2024:

	31 Dhjetor 2024	%
DKInvest Holding AG	57,258,900	60%
SAAL - Investments Holding AG	38,172,600	40%
Totali	95,431,500	100%

Më 31 Dhjetor 2023, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) totali i kapitalit të regjistruar është 15,963,500 lekë.

Më poshtë është struktura e kapitalit më 31 Dhjetor 2023:

	31 Dhjetor 2023	%
DKInvest Holding AG	9,578,100	60%
SAAL - Investments Holding AG	6,385,400	40%
Totali	15,963,500	100%

Fitimi neto i vitit 2024 është 7,100,570 lekë.

14. Shitje e shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e të mirave dhe shërbimeve janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shitje Shërbimesh dhe mallra	20,566,913	935,260
Total	20,566,913	935,260

15. Prodhim i AAGJM

	31 Dhjetor 2024 Leka	31 Dhjetor 2023 Leka
Prodhim i AAGJM	341,687,604	83,255,144
Total	341,687,604	83,255,144

16. Kosto e mallrave

	31 Dhjetor 2024 Leka	31 Dhjetor 2023 Leka
Gendja ne fillim	69,307,269	-
Shpenzime blerje materiale e produkte	133,444,272	109,179,133
Transport	-	-
Sherbime doganore	135,096	11,719
Takse doganore	57,296	241,222
Gendja ne fund	-60,338,553	-69,307,269
Kostoja e materialeve e produkteve (KMSH)	142,605,380	40,124,805
Totali	142,605,380	40,124,805

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

17. Kosto e shërbimeve

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Data Transit	14,060,393	915,619
Blerje interneti	9,305,037	1,191,089
National Backbone Leasing	5,806,203	747,174
Sherbime interkonjeksioni	483,808	-
Sherbime te tjera	420,445	-
Total	30,075,885	2,853,882

18. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Paga	87,165,794	17,582,441
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	12,553,556	2,428,024
Totali	99,719,350	20,010,465

19. Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Qira	16,818,910	3,267,948
Publicitet, reklama	14,615,193	2,576,279
Sherbime Profesionale	4,882,907	1,419,584
Bl.energjii, avull, uje	3,240,717	242,225
Shpenzime Karburanti	3,008,396	317,785
Shpenzime licensa, kuota e te ngjashme	2,572,589	77,477
Shpenzime te panjohura	2,160,985	934,109
Transport	1,573,760	38,899
Trajnime e te tjera per personelin	1,261,030	46,357
Sponsorizime	1,088,020	-
Mirembajtje e te tjera	1,080,643	264,857
Shpenzime noteriale & ligjore	1,021,207	8,676
Shpenzime telekomunikacioni	586,724	30,524
Sherbime bankare	550,023	132,078
Taksa dhe tarifa vendore	463,417	4,375
Te tjera	398,353	60,513
Shpenzime kancelari	296,867	58,893
Shpenzime Instalimi	81,100	-
Gjoha dhe demshperblime	-	27,520
Totali	55,700,840	9,508,099

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

20. Fitim (humbje) nga shitja e aktiveve

	31 December 2023	31 December 2020
Të ardhura nga shitja e aktiveve	394,833	393,921
Vlera e mbetur e aktiveve të shitura	-	-349,975
Totali	394,833	43,946

21. Të ardhurat (shpenzimet) financiare, neto

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të parealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat dhe të tjera të ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitim nga kurset e këmbimit	1,710,079	1,591,013
(Humbje) nga kurset e këmbimit	-2,813,763	-4,497,693
Fitim /(Humbje) neto nga kurset e këmbimit	-1,103,685	-2,906,680
Të ardhurat nga interesi	662	1,750
Shpenzime interesi për huanë	-10,044,526	-
Shpenzime neto interesi	-10,043,863	1,750
Të ardhurat të tjera financiare	36,450	-
Shpenzime të tjera financiare	-	-
Shpenzime të tjera financiare neto	36,450	-
Totali të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	-11,111,098	-2,904,931

22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit fitimit për vitin 2024 i llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
1 Fitimi para tatimit	8,894,188	4,072,914
2 Shpenzime të pazbritshme	2,982,179	934,109
3 Penalitete, gjoba	81,100	-
5 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3+4)	11,957,468	5,007,023
6 Fitim (humbje) e tatueshme	11,957,468	5,007,023
7 Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
8 Shpenzim tatim fitimi	1,793,620	751,053
9 Tatim fitimi i parapaguar	1,034,482	-
10 Tatim fitimi i pagueshem	-759,138	-751,053

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2024

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

23. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2024 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Detyrimet tatimore të Shoqërisë janë pasqyruar pasi janë rakorduar me sistemin e tatim taksave, për TVSH, Kontributet shoqërore dhe shëndetësore, tatimi në burim etj.


Çështje ligjore

Më 31 Dhjetor 2024 nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë ose nga shoqëria.

24. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Prof.Dr.Agim Binaj
Hartues



Albarina Lekëgjan
Administrator



